KUVENDI
NR 4380 DATE 16.12.19

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr.______Prot                                                                 Tiranë më__/__/2019

Lënda :        Ngritja e Komisionit te Posacem per Ndertimin

Drejtuar :     z.Gramoz  RUÇI

**KKRYETAR I KUVENDIT TE SHQIPERISE**

**Tiranë**

z.Kryetar !

Mbështetur në nenin 24,pika 2 të Rregullores së Kuvendit ,ne deputetet e poshtënënëshkruar të ketij akti propozojme ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Ndërtimit.
Vlerësojmë se situata e pas tërmetit të 26 Nëntorit 2019, kërkon vëmëndjen e Kuvendit të Shqipërisë për përgjegjësinë e harmonizimit të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit.

Ngritja e një komisioni të posaçëm për ligjshmërinë në fushën e ndërtimit do ti jepte tonin e duhur sigurisë së jetes,rritjes së standarteve të ndërtimit dhe cilësisë së jetës, stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së zhvillimit të një prej sektorëve kryesorë të ekonomisë së vendit,ndërtimit,  si dhe do të vendoste rekorde të reja për rindërtimin si koncept dhe me standarte.

Ne mendojmë se detyra e këtij komisioni do të jetë,krijimi i një bazamenti ligjor të përhershëm për fushën e ndërtimit.i cili do të nxisë, formatizimin e cilësisë së produkteve të ndërtimit sipas konformitetit,formatizimin e konformitetit të proceseve teknologjike,formatizimin e konformitetit të personelit

teknik,riformatimin e kushteve teknike të projektimit sipas parimeve dhe standarteve të eurokodeve,riformatimin e kushteve teknike të zbatimit sipas standarteve europiane,formatimin e kushteve të mirëmbajtjes dhe monitorimit teknik të qëndrueshmërisë së veprave në tërësi në fushën e ndërtimit,formatimin e kushteve teknike të rikonstruksionit dhe përforcimeve,të restaurimeve,riformatimin e rregullave të sigurimit teknik gjatë ndërtimit,nxitjen dhe implemntimin ligjor të hartave të reja siymike të vendit tonë dhe plotesimi me karkteristika të lëkundjeve në mënyrë periodike,strukturën ligjore të rindertimit,strukturën ligjore të emergjencave të përmbytjeve,tërmeteve dhe zjarrit,monitorimin e programit të rindërtimit,harmonizimin e rregullave për kontrollin e territorit ,përcaktimin e përgjegjesive ligjore të harmonizuara për ndërtimin e çdo objekti që nga fillimi deri në mbarimin e tij (ligjin e sigurisë së ndërtimeve) ,përcaktimin e përgjegjësive ligjore që nga prodhusit e produkteve të ndërtimit deri tek tregëtarët etj.

Mendojmë së puna e këtij komisioni të posaçëm duhet të shtrihet në harkun kohor të paktën të 16 muajve.

Në pritje të konsiderimit të kërkesës sonë ,

Deputetët:

1. ARTUR ROSHI
2. Myslim Murrizi
3. KRENAR RRYÇA
4. Suzana Topi
5. Edlira Hyseni
6. Ylli SHEHU
7. Arlind Çaçorri
8. 
9. 